



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2021:241699

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06005307

C.nr. 311/21

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtarja Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. S. nga ..... të cilën e përfaqëson Lulzim Canaj avokat në Kamenicë, i caktuar nga zyra mobile për ndihmë juridike falas në Kamenicë, ndaj të paditurës Komuna e Kamenicës – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Dr. “Shaban Geci” në Kamenicë, me objekt kontesti Anulimi i vendimit të komisionit disiplinor, me vlerë të kontestit të pa përcaktuar, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik më datë 11.07.2024 dhe dorëzimit të fjalës përfundimtare të përfaqësuesit të paditëses më datë 18.07.2024 dhe dorëzimit të fjalës përfundimtare të të paditurës më datë 17.07.2024, më datë 30.07.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.S. nga ..... .

**II. ANULOHET** vendimi i të paditurës Komuna e Kamenicës - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr.Shaban Geci” në Kamenicë – Komisionit Disiplinor, me nr.08-511 i datës 28.09.2021 dhe vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave pranë QKMF-së në Kamenicë nr.08-554 i datës 19.10.2021 si dhe paditëses t’i kthehet ndalesa prej 20 % e pagës në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, detyrohet e paditura që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, për zbatimin e të njëjtit, nën kanosjen e përmbarimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET kërkesa e përfaqësuesit të paditëses që e paditura t'ia kompensoj shpenzimet procedurale kontestimore edhe atë për padi shumën prej 104 € dhe për përfaqësim në 3 seanca(3×135.20€) në shumën totale prej 509.60 €.

IV. Shpenzimet e procedurës për taksë gjyqësore bien mbi barrën e kësaj gjykate.

## **A r s y e t i m**

### **1.Rrjedha e procedurës**

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 25.10.2021, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës me objekt kontesti anulimi i vendimit, nr.08-511 të datës 28.09.2021 të Komisionit Disiplinorë dhe vendimin e komisionit të ankesave Nr.08-554 të datës 19.10.2021.

### **2.Pretendimet e palëve ndërgjyqësore**

Në padi, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe në shpjegimet përfundimtare, e njëjta përmes të autorizuarit të saj ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paditëses, dhe kërkon që të anulohet vendimi i datës 08.10.2021, i Komisionit të Ankesave pranë QKMF-së në Kamenicë, pasi që komisioni ka qenë i formuar në mënyrë të kundërligjshme për nga përbërja, andaj edhe vetë vendimi i nxjerrë ka qenë i kundërligjshëm, ngase pas administrimit të provave, janë vërtetuar pretendimet e palës paditëse, se nuk qëndrojnë asnjë nga provat e palës së paditur, dhe se këto prova nuk janë të bazuara në fakte reale, por janë qëllime tendencioze ndaj paditëses me qëllim të diskriminimit të personalitetit të sajë. Tutje përfaqësuesi me autorizim i paditëses ka theksuar se komisioni disiplinor nuk ka qenë i formuar në pajtim me legjislacionin në fuqi, pasi që me nenin 72 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114, është përcaktuar qartë se komisioni disiplinor përbëhet prej 5 anëtarëve, dhe komisioni i njëjtë me datë 16.09.2021 ka mbajtur seancë pa qenë prezent edhe përfaqësuesi i sindikatës së punëtorëve i cili mbron të drejtat e punëtorëve. Tutje ka theksuar se inicimi i procedurës disiplinore është bërë nga ushtruesi i detyrës së Drejtorit të QKMF-së, i cili pretendon se pastrimi nuk është bërë me datë 15.08.2021, duke u bazuar në Inspektimin e bërë nga Inspektorati i Ministrisë së Shëndetësisë, sipas procesverbalit të këtij Inspektorati nr. rendor 00269 të datës 06.08.2021, shihet se as sipas orarit nuk ka qenë e angazhuar paditësja aty, dhe

çka është më e rëndësishmja, ky inspektim nuk ka të bëjë fare me situatën rreth pastrimit në Qendrën e Vaksinimit, por ka të bëjë me monitorimin e punëtorëve shëndetësor – mjekëve rreth natyrës së menaxhimit të kësaj situate me covid, prandaj si provë kyçe e paraqitur nga pala e paditur, nuk qëndron fare, andaj edhe shqiptimi i masës disiplinore është i gabuar dhe i njëanshëm, prandaj i ka propozuar gjykatës që të aprovet kërkesëpadija e paditëses. Shpenzimet i ka kërkuar, dhe atë për padi shumën prej 104.00 euro, dhe për 3 seanca gjyqësore shumën prej nga 135.20 euro, në total shumën prej 509.60 euro.

E paditura në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe në shpjegimet përfundimtare, përmes të autorizuarit së saj ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, lidhur me anulimin e vendimit të komisionit disiplinor dhe komisionit për ankesa, për shkak se komisioni disiplinor duke u bazuar në provat materiale, ka nxjerrë vendim të drejtë me të cilin e ka bërë ndalesën e 20% të pagës për 3 muaj ndaj punëtores S.S., dhe një gjë e tillë vërtetohet edhe nga raporti i inspektoratit të Ministrisë së Shëndetësisë, ku është konstatuar se pjesa për të cilën ka qenë e angazhuar paditësja ka qenë jo në nivelin e duhur në kohën kur ka pasur pandemi sipas institutit lidhur me këtë Covid19, dhe se komisioni ka qenë i formuar në pajtim me ligjin. Tutje përfaqësuesi i të paditurës ka theksuar se paditësja me asnjë provë të vetme, nuk e ka dëshmuar se ka arritur ta provoj kërkesën e sajë, dhe nuk e ka bazuar në prova të pranueshme, ngase nga konstatimet e komisionit shihet se punëmarrësja ka shkelur kontratën e punës, dhe nuk i ka përmbushur detyrat e sajë, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses.

Shpenzimet i ka kërkuar në total të përgjithshëm shumën prej 645.60 Euro.

### **3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, ka administruar këto prova materiale: Ankesa e drejtuar komisionit të ankesave pranë QKMF Dr. “Shaban Geci” në Kamenicë, me nr.30727 e datës 08.10.2021, Vendimi i QKMF Dr. “Shaban Geci” në Kamenicë me nr.08-554 i datës 19.10.2021, Vendimi i QKMF Dr. “Shaban Geci”, në Kamenicë me nr.08-511, i datës 28.09.2021, raporti mjekësor i Ambulancës Specialistike për alergologji, imunologji klinike, në emër të Selvete Sijarinës, i datës 29.02.2020, raporti i Inspektoratit të Shëndetësisë – Ministria e Shëndetësisë, Republika e Kosovës me nr. referencës 10/M-087-21, i datës 16.09.2021, Raporti mjekësor i Klinikës së Psikiatrisë – Spitali

i Përgjithshëm në Gjilan, me nr.3092 i datës 05.08.2021, në emër të S. S., Raporti i ordinancës specialiste psikiatrike “psikiatër” doktorit të psikiatrisë Qemajl Rexhepi, me numër të protokollit 335/21, të datës 01.02.2021 në emër të S.S., Udhëzimi mjekësor i udhëzuar për në spitalin regjional në Gjilan, me nr të regjistrit 16267 i datës 04.08.2021 në emër të S.S., deklarata e dhënë me shkrim dore nga paditësja, me datë 17.08.2021, raporti mjekësor nga ordianca specialiste, psikiatrike “psikiatër” me nr.893/21 i datës 31.03.2021 në emër të S.S., Procesverbali i komisionit disiplinorë pranë QKMF Dr. “Shaban Geci” në Kamenicë, i datës 16.09.2021, Deklara e Dr.Besim Beqiraj, u.d drejtor i QKMF-së, drejtuar komisionit disiplinor të QKMF-së, me nr të protokollit 08-478 e datës 17.09.2021, Njoftimi i kryeinfermieres në QKMF në Kamenicë, me nr.08-506 i datës 27.09.2021, Njoftimi i F. Sh., drejtuar komisionit disiplinor të QKMF-së me nr.08505 i datës 27.09.2021, Orari i pastruesve për muajin Gusht 2021, me nr.08-392, i datës 29.07.2021, Lexohet raporti i Ministrisë së Shëndetësisë, Republika e Kosovës – Inspektorati Shëndetësor, me nr protokollit 05-641 i datës 17.09.2021, bashkangjitur procesverbalet mbi inspektimin e kryer me nr rendor 00269 të datës 16.08.2021, dhe procesverbali mbi inspektimin e kryer me nr. rendor 00275 i datës 26.08.2021, dëgjimi i paditëses, S.S.

Gjykata në bazë të çmuarjes me kujdes dhe ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, si në nenin 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, ngase:

Nga Vendimi i QKMF Dr. “Shaban Geci” në Kamenicë me nr.08-554 i datës 19.10.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave pranë QKMF-së e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses të datës 08.10.2021.

Nga Vendimi i QKMF Dr. “Shaban Geci”, në Kamenicë me nr.08-511, i datës 28.09.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura, kishte marrë vendim me të cilin paditëses S.S.i kishte shqiptuar masën ndalimi i 20% të pagës për një periudhë në kohëzgjatje prej 3 muajve.

Nga raporti i Inspektoratit të Shëndetësisë – Ministria e Shëndetësisë, Republika e Kosovës me nr. referencës 10/M-087-21, i datës 16.09.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se Inspektorati shëndetësor me datë 16.08.2021 ka bërë inspektimin dhe me datë 26.08.2021 ka bërë ri-inspektimin në Qendrën e Vaksinimit në kuadër të QKMF-së në Kamenicë.

Nga Deklarata e dhënë me shkrim dore nga paditësja, me datë 17.08.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se, paditësja me datë 17.08.2021 kishte dhënë deklaratë me shkrim.

Nga Procesverbali i komisionit disiplinorë pranë QKMF Dr. “Shaban Geci” në Kamenicë, i datës 16.09.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 16.09.2021 është mbajtur seancë dëgjimore nga Komisioni Disiplinor pranë QKMF-së në Kamenicë, me përbërje të komisionit Dr.Grani Krasniqi – Kryesues, Hyr Maroca – anëtar, Dr.Kadrush Morina – anëtarë dhe Sherife Berisha – anëtare.

Nga Deklarata e Dr.Besim Beqiraj, u.d drejtor i QKMF-së, drejtuar komisionit disiplinor të QKMF-së, me nr të protokollit 08-478 e datës 17.09.2021, gjykata vërtetoi faktin se me datën e lartcekur Dr.Besim Beqiraj në një deklaratë të hartuar me shkrim ka theksuar se me datën 16.08.2021 ka qenë inspektorati nga Ministria e Shëndetësisë te qendra e vaksinimit, është njoftuar se kanë gjetur mbeturina tjera dhe objektet kanë qenë të pa pastruara nga punëtorja e cila ka qenë e angazhuar në pastrim .

Nga Njoftimi i kryeinfermieres në QKMF në Kamenicë, me nr.08-506 i datës 27.09.2021, gjykata vërtetoi faktin se me datë **27.09.2021** është lëshuar një njoftim ku është përshkruar se për shkak të pushimeve vjetore që kanë qenë në muajin Gusht, pastrueset që kanë pastruar Mjekësinë Familjare, kanë qenë të obliguara të pastrojnë edhe shërbimin e vaksinimit.

Nga Njoftimi i Fisnik Shala, drejtuar komisionit disiplinor të QKMF-së me nr.08505 i datës 27.09.2021, gjykata vërtetoi faktin se Fisnik Shala në një deklaratë të hartuar me shkrim ka theksuar se zgjedhjet e sindikatës janë nga data 02.09.2021 andaj nuk ka pasur mandat të përfaqësorj dhe prezantoj, pranë komisionit disiplinor.

Nga Orari i pastruesve për muajin Gusht 2021, me nr.08-392, i datës 29.07.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësja për muajin gusht ka qenë me orar nga ora 07:00 deri në ora 15:00.

Nga raporti i Ministrisë së Shëndetësisë, Republika e Kosovës – Inspektorati Shëndetësor, me nr protokollit 05-641 i datës 16.09.2021, bashkangjitur procesverbalet mbi inspektimin e kryer me nr rendor 00269 të datës 16.08.2021, dhe procesverbali mbi inspektimin e kryer me nr. rendor 00275 i datës 26.08.2021, gjykata vërtetoi faktin se, procesverbalet e lartcekura mbi inspektimin, të datës 16.08.2021 dhe 26.08.2021, kishin të bëjë me atë se specializantët a

gjenden në vendin e punës dhe a po zbatohet Qarkorja nr.07/2021 me nr protkollit 05-5475, ku edhe me të njëjtët procesverbal është urdhëruar një gjë e tillë, dhe nuk kishte të bëjë fare me inspektimin lidhur me pastrimin në QKMF apo në qendrën e vaksinimit.

### **3.1 Dëshmia e dëshmitarit Besim Beqiraj.**

Dëshmitari Besim Beqiraj nga Prishtina, në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 03.06.2024, ka deklaruar se, sipas të dhënave që ka marrë nga Inspektorati Shëndetësor, është njoftuar se qendra e vaksinimit ka qenë e pa pastruar dhe ka kërkuar nga udhëheqësit që kanë qenë të caktuar në këtë qendër të marrin masa dhe të shqyrtojnë rastin komfor ligjit dhe rregullores në fuqi, sipas informatave komisioni ka marr deklaraten e punëtores, orari I punës për stafin, protokollohet dhe vendoset në vend adekuat në hyrje të QKMF-së në korridor, lëvizje mundë të ketë në mungesë të ndonjë punëtori tjetër e këtë munde ta bëjë përgjegjësi për secilin sektor edhe me gojë, pasi që nuk guxon të mbetet pa shërbim cilado qoftë pjesë, tutje dëshmitari ka theksuar se për caktimin e pastrueseve për pastrim në QKMF, është përgjegjësja e cila merret me orar të punës, ka kërkuar përgjegjësi nga përgjegjësja që shërbimi të jetë në nivel, dhe nuk kanë pas rëndësi emrat e punëtorëve kush ka punuar nga se të gjithë punëtorët janë të njëjtë.

### **3.2 Dëshmia e dëshmitarit Hyr Marovca**

Dëshmitari Hyr Marovca nga Kamenica, në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 03.06.2024, ka deklaruar se, është udhëheqës i sektorit të shëndetësisë në QKMF në Kamenicë - udhëheq administratën dhe burimet njerëzore, ka theksuar se komisioni disiplinor formohet për një periudhë dy vjeçare komfor ligjit, edhe ky është anëtar i komisionit ex officio, ka marrë pjesë si anëtar i komisionit disiplinor por jo edhe si anëtar i shqyrtimit të ankesave dhe parashtrësive, vet punëtorja ka pranuar se nuk i ka kryer detyrat e punës, për të cilën ekziston edhe deklarata e saj e nënshkruar, komisioni ka pasur provë se nuk është kryer puna si duhet dhe se paditësja ka qenë e angazhuar në të njëjtën ditë në orar të punës dhe i është dorëzuar edhe orari i punës.

### **3.3 Deklarata e paditëses S. S.**

Paditësja S.S. nga ..... në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 03.06.2024, ka deklaruar se, gjatë punës i janë bërë shumë padrejtësi, pasi ka ardhur në krye të detyrës Besim Beqiraj dhe Hyr Marovca, para vitit 2020 ka pasur 12 vite përvojë pune dhe asnjëherë nuk ka pasur asnjë

vërejtje gojore apo me shkrim, ndërsa pas ardhjes në krye i njëjti dy herë ka marrë vendime dhe atë një here e ka suspenduar një muaj me 50% të pagës, nga presioni në punë ka kërkuar edhe ndihmë mjekësore në psikiatri dhe qe dy vite përdor terapi, vendimi i dytë i UD të drejtorit të QKMF-së është inicuar për vërejtjen të cilën e ka lënë inspektori e cila vërejtje nuk ka pas të bëj me pastërtinë e objektit dhe i është shqiptuar ndalesë prej 20%, paditësja ka theksuar se me datë 15.08.2021 ka qenë e caktuar të punoj në Urgjencë dhe Mjekësinë Familjare, ndërsa raportin të cilin e ka lënë inspektori i Ministrisë së Shëndetësisë ka pas të bëjë me qendrën e vaksinimit, e cila nuk ka qenë e caktuar të punoj në atë sektor, ka punuar punëtor tjetër, ndërsa të shtunave dhe të dielave ky sektor nuk ka punuar në atë kohë, inspektoriat të hënën ka inspektuar në ora 12:15 minuta, e që e njëjta paradite ka qenë në shtëpi, orari i saj (Paditëses) ka qenë pasdite nga ora 14:00 deri 22:00, e caktuar për këtë ditë të pastroj ka qenë N.K. ndërsa vikendeve punon nga 12 orë.

#### **4. Baza ligjore**

Sipas Ligjit të punës me Nr. 03/L-2012, marrëdhënia e punës përkufizohet si “një marrëveshje ose rregullim kontraktual ndërmjet një punëdhënësi dhe të punësuarit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi specifike nga i punësuarit nën mbikëqyrjen e punëdhënësit, kundrejt një pagese të dakorduar, zakonisht në formë të parave;” ndërsa kontrata e punës përkufizohet si “akti individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit;” Duke u bazuar në nenin 85 paragrafi 1të Ligjit të Punës “Për shkeljen e detyrave të punës, të punësuarit do t’i shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese: 1.1. vërejte me gojë; 1.2. vërejtje me shkrim; 1.3. ulje në pozitë; 1.4. suspendim të përkohshëm; 1.5. ndërprerje të marrëdhënies së punës.” Në nenin 47 të Ligjit për Zyrtarë Publik Nr.06/L-114 përcaktohet se “Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil.” Ndërsa në nenin 48 të po të njëjtit ligj përcaktohet se “Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor.

*Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit; 4.3. me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore. Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të ndihmohet gjatë procedurave disiplinore nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, nga një avokat apo nga një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate. Procedura disiplinore fillon pa vonesë, me marrjen në dijeni për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda një afati dyvjeçar (2) nga data e kryerjes së shkeljes. Në rastin e shkeljeve të rënda, që mund të rezultojnë në marrjen e masës disiplinore të largimit nga Shërbimi Civil, afati është tetë (8) vjet. Masat disiplinore regjistrohen në dosjen personale të nëpunësit. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedurën e hollësishme disiplinore, në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.” Ndërsa në Rregulloren për përcaktimin e përgjegjësive dhe procedurave disiplinore Nr.08-845 të datës 25.05.2018, në nenin 2 përcaktohet se “Kjo rregullore zbatohet vetëm në marrëdhënien e punës të punësuarve në rrjetin e institucioneve të QKMF-së përkitazi me përgjegjësinë disiplinore dhe masave që mundë ti shqiptohen të punësuarit në rast të shkeljes së supozuar.” “Llojet e shkeljeve disiplinore 1. I punësuarit gjatë marrëdhënies së punës përmes veprimeve të tij individuale apo në bashkëveprim mundë ti kryej 1.1 Shkelje të lehta disiplinore dhe 1.2 Shkelje të rënda disiplinore. 2. Duke mos u kufizuar në paragrafin 1 të këtij neni, në kuadër të shkeljeve disiplinore mundë të përfshihen edhe veprime të tjera që nuk janë paraparë me këtë rregullore e që mundë të ndikojnë në mbarëvajtjen e funksionimit të punës të Institucionit përkatës shëndetësorë.*



## 5. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata pas vlerësimit dhe analizimit të fakteve të paraqitura nga paditësja dhe e paditura ka gjetur se nuk është kontestuese se paditësja S. S. është në marrëdhënie pune me të paditurën.

Mes palëve ndërgjyqëse, fakt kontestues në këtë procedurë është ligjshmëria e vendimit mbi ndalesën e pagës në shumë prej 20% për tre (3) muaj.

Nga këto fakte, gjykata ka konstatuar se e paditura, masën e shqiptuar për ndalesën e pagës në shumë prej 20% për 3 muaj e ka bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht në kundërshtim me ligjet e cituara më lartë, ngase arsyetimi lidhur me masën e shqiptuar, është i bazuar tërësisht në Procesverbalin e Inspektoratit të Shëndetësisë nr.00269, të datës 16.08.2021 dhe 26.08.2021, e i cili procesverbal, ka të bëjë krejtësisht me diçka tjetër, përkatësisht kishte të bëjë me atë se *“specializantët a gjenden në vendin e punës dhe a po zbatohet Qarkorja nr.07/2021 me nr protokollit 05-5475, ku edhe me të njëjtin procesverbal është urdhëruar një gjë e tillë”*, dhe nuk kishte të bëjë fare me inspektimin lidhur me pastrimin në QKMF apo në qendrën e vaksinimit, ndërsa në shkresat e lëndës, gjykata nuk posedon asnjë provë, që paditësja të ketë, lënë pas dore pastrimin, përkatësisht një gjë e tillë të jetë konstatuar në ndonjë inspektim nga Inspektorati Shëndetësor, dhe *për të njëjtën të jetë përpiluar ndonjë procesverbal, si provë se paditësja nuk i ka kryer punët dhe detyrat e sajë lidhur me pastrimin adekuat*. Në anën tjetër me provat e administruara është vërtetuar se paditësja në momentin e inspektimit nga Inspektorati i Shëndetësisë, paditësja fare nuk ndodhej në vendin e punës, përkatësisht inspektimi - inspektorati kishte qenë në ora 12:15 minuta, e që për këtë ditë kishte qenë e caktuar të pastroj Nafije Kurteshi dhe ditën kur ka qenë inspektorati paradite ka qenë në shtëpi nuk ka qenë në punë, ndërsa inspektorati ka ardhur para dite në 12:15, orari i saj (Paditëses) ka qenë pasdite. Në rastin konkret gjykata zbatoi nenin 7 par.1 të Ligjit për procedurën Kontestimore në të cilin decidivisht përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”* Si dhe nenin 322 par.1 *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës.”*

Andaj gjykata në rastin konkret, nuk ka mundur të aprovojë si të drejtë dhe të ligjshëm, vendimin për masën e shqiptuar për paditësen, për ndërprerjen prej 20% të pagës për periudhën

për 3 (tre) muaj, ngase vendimi i tillë, ka të meta për shkak të së cilave mund qartë të konstatohet kundërligjshmëria e tij, pasi që është marr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren për përcaktimin e përgjegjësiave dhe procedurave disiplinore Nr.08-845.

Sipas nenit 7 të ligjit për procedurën kontestimore, palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa me dispozitat e nenit 319.1 të LPK-së, parashihet se secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë t'i provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Në rastin konkret pala e paditur me asnjë provë të vetme nuk arriti të argumentoi se vendimi masën e shqiptuar paditëses është i drejt dhe i ligjshëm, e për të cilën ka pasur obligim në kuptim të dispozitës së nenit 322.3 të LPK-së.

Gjykata, ka administruar edhe prova tjera materiale, por, të cilat ishin të pa ndikim dhe si të tilla nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore.

### **5. Shpenzimet e procedurës**

Vendimin lidhur me shpenzimet procedurale gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 468.1 dhe 4 të LPK-së, duke marr parasysh faktin se paditësja ka kushte jo të mira ekonomike, për çka edhe është përfaqësuar nga zyra mobile për ndihmë juridike falas në Kamenicë, andaj pagimi i taksës gjyqësore do të ndikonte në rrezikimin e drejtpërdrejtë të ekzistencës së saj dhe familjes, ndërsa ka REFUZUAR kërkesën e përfaqësuesit të paditëses që e paditura , paditëses t'ia kompensoj shpenzimet procedurale kontestimore edhe atë për padi shumë prej 104 €, për përfaqësim në 3 seanca(3×135.20€) në shumë prej 405.60 €, e në shumën totale prej 509.60 €. bazuar në faktin se sipas vendimit në shkresa të lëndës me nr. C.nr.19/22 të datës 20.05.22 i autorizuari i paditëses ishte i caktuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, shpenzimet e kësaj Agjencie mbulohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, andaj gjykata vendosi sikurse në pikën III dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura dhe në nenin 143 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2021:241699, 30.07.2024**

**Gjyqtarja,  
Valbonë Dërvodeli,d.v.**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.